

Elton Mucollari: Jemi te mobilizuar per te fituar

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 30 Nentor 2013 00:13



Ne ndeshjen e kontrollit qe skuadra e Kastriotit zhvilloi ne pergatitjet e fundit perpara takimit me Bylis, trajneri Mile aplikoi variantin taktik 4-4-2, format me te cilin pritet te luaje edhe ne ndeshjen ndaj Ballshiotëve. Per Kastriotin, pritet te aktivizohet edhe mesfushori Elton Mucollari i cili ka shume mundesi qe do te aktivizohet pa masken mbrojtese qe mbante ne fytyre pas demtimit qe pesoi disa jave me pare. “ Nuk ka me skuadra te medha apo te vogla, te gjithë jane te barabarte. Ndeshja ndaj ballshiotëve eshte mjaft e rëndesishme si per ne ashtu edhe per miqtë. Marrja e fitores eshte objektivi kryesor per ne. Cdo rezultat tjetër kompromenton dukshem ecurine e skuadres ne kete kampionat” eshte shprehur mesfushori Elton Mucollari qe ndeshjen e kontrollit ka lujtur pa masken mbrojtese.